

**INVESTIMI**  
 Rikualifikimi urban i bllokut Babrru-Qendër, inspekton punimet kryebashkiaku Mziu  
 FAQE 4



**SOCIALE**  
 Në vëmendjen e Bashkisë, përmirësimi i infrastrukturës së arsimit në shkollat dhe kopshtet e qytetit  
 FAQE 4



**KULTURË**  
 Ansambli i Kamzës merr çmimin "Margaritar i Kulturës Popullore" në festivalin "Burimet e Sharrit" në Tetovë  
 FAQE 7



**TALENTI I KAMZA BASKET**  
 Ergys Muhametaj, krah lojtarëve të moshave të ekipeve si Real Madrid, Barcelona, Fenerbahçe e kolegjeve amerikane  
 FAQE 6



Gazetë e Bashkisë Kamëz

# KAMZA

E përdyjavshme  
 Nr. 204 shtator 2017  
 Çmimi 20 lekë  
 drmediakamez@gmail.com  
 www.kamza.gov.al

## Investimet e Bashkisë Kamëz në 10 vite, me karakter social, në ndihmë të mijëra qytetarëve

FAQE 4

**Kryebashkiaku Xhelal Mziu inspekton punimet për asfaltimin përfundimtar të bulevardit "Demokracia" në Paskuqan**

Faqe 4

**350 biznese të reja kanë çelur aktivitetin e tyre duke gjetur terrenin e duhur në Kamëz**

Faqe 5

**Bashkia Kamëz, e ftuar në Forumin e Qeverisjes së Danubit "Përmirësimi i qeverisjes së bashku"**

Faqe 3

**Qeveria e majtë, e shurdhër ndaj kërkesave për financim të projekteve për ndërtimin e shkollave dhe kopshteve të tjera**

Faqe 4



**Bashkia Kamëz, luftë informalitetit dhe rritje të cilësisë së shërbimeve**

FAQE 2



### NË BRENDESI

**Takimi me përfaqësuesin e kompanisë "Dahlem", kryebashkiaku Mziu: Jam i vendosur për të mbrojtur qytetarët e Kamzës**

FAQE 8

**Bashkia Kamëz dhe American Councils for International Education njoftojnë nxënësit e qytetit për bursa studimi në SHBA**

FAQE 3

**Kryebashkiaku Xhelal Mziu dhe drejtori i Përgjithshëm i kompanisë SIGAL, Avni Ponari, në klinikën lëvizëse në Bathore**

FAQE 8

**Kryebashkiaku Xhelal Mziu mbledh grupet e punës për situatën e informalitetit**

FAQE 2

**Mbrojtësi i djathtë i Kamzës, Frashëri: Në ndeshjet e para kemi qenë të pafat**

FAQE 7





## Kryebashkiaku Xhelal Mziu mbledh grupet e punës për situatën e informalitetit

Kryebashkiaku Xhelal Mziu në një takim të zhvilluar në ambientet e Bashkisë, mbledhi grupet e punës që operojnë në terren për të diskutuar problematikën e informalitetit dhe masat që duhen marrë për zbutjen e saj.

Janë angazhuar rreth 70 punonjës për të monitoruar në terren të gjithë situatën debitore, e cila për arsye subjektive, ka krijuar një boshllëk në realizimin e buxhetit të planifikuar. Reforma territoriale e vitit 2015 solli edhe para Bashkisë Kamëz një vështirësi për të mirëmenaxhuar elementet e vjeljes së detyrimeve të të gjitha kategorive që janë përbërës të paketës fiskale të miratuar në fillim të vitit.

“Situata debitore, - theksoi



kryebashkiaku Mziu, - e krijuar artificialisht na vë përpara përgjegjësi ligjore për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit për të bashkëpunuar me të gjitha kategoritë e sugjeruara për të neutralizuar këtë situatë, qofshin këta familjarë, objekte social-kulturore që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Bashkisë Kamëz, apo subjekte private të regjistruara si biznes po në këtë territor”.

Pasi analizoi me imtësi se ku janë burimet në të cilat është krijuar ky debit, kreu i Bashkisë theksoi qartazi të gjitha elementet efçente që duhen përdorur



pikërisht nga grupet e punës në terren për të realizuar pikërisht objektivin e përcaktuar. Për këtë qëllim, organizimi është bërë sipas ndarjeve administrative të lagjeve, në të cilat ndodhet 38 të tilla në Kamëz dhe 12 në Paskuqan. Grupet janë organizuar me nga dy punonjës të administratës së Bashkisë si dhe nga një përfaqësues (ndërlidhës me komunitetin) për të bashkërenduar punët për vjeljen e debive. Periudha e punës që do të shërbejë për të përmirësuar këtë situatë do të jetë deri në fund të muajit tetor 2017.

### Bashkia Kamëz, luftë informalitetit dhe rritje të cilësisë së shërbimeve



Në territorin e Bashkisë Kamëz ende ka familje të cilat aktualisht kanë një ose më shumë ndërtime, të cilat për një ose disa arsye nuk e kanë lejen e banimit në Kamëz, kur shërbimet i kryen për të gjitha kategoritë kjo Bashki, ndërsa grantet për këto familje i merr një tjetër njësi administrative, e cila nuk u kryen shërbimet e përcaktuara familjeve në fjalë.

Për këtë, bazuar në ligjin shqiptar, për të vendosur lejet e banimit në adresën e duhur, do të aplikohet taksa e luksit, e cila do të verifikohet në terren nga përbërësit e grupeve të punës dhe do të aplikohet në mënyrë të menjëhershme mbledhja e tyre. Kjo është një nga masat që do të ndërmarrë Bashkia Kamëz për të luftuar informalitetin dhe nëpërmjet kësaj për të ofruar edhe shërbime më cilësore për qytetarët.

Për këtë qëllim, është bërë edhe organizimi në grupe pune sipas ndarjeve administrative të lagjeve, të cilat janë 38 në Kamëz dhe 12 në Paskuqan. Grupet janë organizuar me nga dy punonjës të administratës së Bashkisë si dhe nga një ndërlidhës me komunitetin. Janë angazhuar rreth 70 punonjës për të monitoruar në terren të gjithë situatën debitore dhe atë të informalitetit dhe për të bërë të mundur realizimin e buxhetit të planifikuar.

### Angazhim i Ndërmarrjes së Ujësllës-Kanalizimeve Kamëz për të përmirësuar situatën debitore

Angazhim i strukturave të Ndërmarrjes së Ujësllës-Kanalizimeve dhe i grupeve të punës për të përmirësuar situatën debitore dhe për të luftuar informalitetin. Në kuadër të aksionit të përgjithshëm të Bashkisë për luftën ndaj informalitetit, edhe ky sektor shërbimesh gjatë kësaj periudhe do të jetë pjesë e grupeve të punës të ngritura. Së pari, do të eliminohet debia e krijuar me kontratat e pahapura të ujit për subjektet që furnizohen me ujë nga sistemet ujësllëse të Bashkisë Kamëz si dhe kontratat e KUN (kanalet e ujërave të ndotura) në të gjithë territorin e Bashkisë. Të gjithë abonentët që furnizohen nga burimet ujore që janë në administrim të së Ujësllës-Kanalizimeve Tiranë duhet të pajisen me kontratën e KUN-së, kur ky shërbim kryhet nga Bashkia Kamëz. Grupet e punës do të kenë në patronazh të gjitha familjet që nuk kanë adresë të përcaktuar dhe nëpërmjet sistemit GIS do të bëjnë mirëpërcaktimin e adresës së saktë të këtyre familjeve. Për të gjitha familjet që furnizohen me ujë të pijshëm nga burimet e ujësllësit të Bashkisë Kamëz, do të kryejnë shlyerjen e detyrimeve sipas matësve të vendosur dhe aty ku nuk ka matës me çmimin e miratuar në Këshillin Bashkiak. Ndërkaq, puna e Ndërmarrjes së Ujësllës-Kanalizimeve Kamëz vijon me ofrimin e shërbimit të përditshëm dhe investimin në rrjetin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, mes të cilave është edhe faza e dytë e projektit me KfW-në, që do të garantojë 24 orë ujë për qytetarët.

### Kamëz, verifikim në terren i objekteve dhe implementim në sistemin elektronik të taksave e tarifave vendore

Në mungesë të financimeve të projekteve dhe të granteve nga ana e qeverisë, Bashkia Kamëz në katër vite është përpjekur të shfrytëzojë çdo burim të ligjshëm për të realizuar investime shumë të nevojshme publike dhe për të ofruar shërbime cilësore për qytetarët. Ndërkaq, një tjetër element tjetër që ka ndikuar në krijimin e një sate debitore në Bashkinë Kamëz është edhe taksa e infrastrukturës. Familje të tëra kanë përfituar procesin e legalizimit të objekteve. Në këtë kategori përfshihet edhe taksa e infrastrukturës, përgjegjëse për vjeljen e së cilës është institucioni i Bashkisë. Edhe për këtë kategori do të bëhet verifikimi në terren, më pas pasqyrimi në sistemin e taksave si situatë debitore dhe do të merren masat e duhura për të vjelë pikërisht këtë mbetje debitore. E gjithë kjo situatë do të bëjë që Bashkia të vërë në funksion të gjithë mekanizmat e duhur për të bërë të mundur eliminimin e kësaj sate. Për këtë në bashkëpunim me ekspertët e IT-së, në Bashkinë Kamëz po përgatiten formularët me të gjithë elementët e duhur infrastrukturorë që do t'u shërbejnë grupeve të punës për të mbledhur informacionin e saktë në terren dhe për ta implementuar në sistemin elektronik të taksave vendore.

### Të ardhurat e mbledhura nga subjektet private shndërrohen në investime për qytetarët e Bashkisë Kamëz

Lufta ndaj informalitetit që Bashkia Kamëz ka shpallur, do të jetë e pashmangshme në vazhdimësi, me qëllimin për të mos pasur më të privilegjuar dhe të jenë të gjithë të barabartë përpara ligjit dhe shërbimeve.

Kjo bëhet në një kohë kur qeveria shqiptare vazhdon ta shohë Bashkinë Kamëz me syrin e njerësisht, pavarësisht se në këtë qytet bashkëjetojnë së bashku edhe demokratët, edhe

socialistët. Një tjetër përgjegjësi e grupeve të punës në terren ka të bëjë me biznesin, për të realizuar eliminimin e debive edhe në subjektet private. Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve (Urbanistika) janë përgatitur hartat e territoreve sipas organizimit të grupeve për të bërë mirorientimin e tyre për të punuar lehtësisht në terren.

Nga ana e strukturave të Bashkisë kërkohet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha subjektet, qofshin këto familje apo subjekte private, për të ndihmuar në përmirësimin e ndjeshëm të situatës debitore që është krijuar dhe për t'i shndërruar këto të ardhura në investime dhe shërbime ndaj qytetarëve të Bashkisë Kamëz.



# Bashkia Kamëz dhe American Councils for International Education njoftojnë nxënësit e qytetit për bursa studimi në SHBA

Shtator 2017  
GAZETA KAMZA

3



Bashkia Kamëz dhe American Councils for International Education njofton nxënësit e qytetit për programin e bursave Kennedy Lugar Youth Exchange and Study të Departamentit Amerikan të Shtetit. Ky program është i hapur edhe për nxënësit e shkollave të mesme, të klasave 10 dhe 11 dhe që janë të lindur më 1 janar 2001 deri më 15 korrik 2003.

YES – Youth Exchange and Study është një program pa pagesë që siguron bursa studimi për nxënësit e shkollave të mesme nga vendet YES për të kaluar deri në një vit akademik (2018-2019) në Shtetet e Bashkuara, duke jetuar me familje amerikane dhe duke ndjekur një shkollë të mesme amerikane. Fokusi i programit është zhvillimi i komunikimit ndërmjet qytetarëve nga Shtetet e Bashkuara dhe vendeve partnere, me qëllim ngritjen e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Nxënësit jetojnë në një familje pritëse,



ndjekin një shkollë të mesme, angazhohen në aktivitete për të mësuar mbi shoqërinë dhe vlerat amerikane, sigurojnë aftësi drejtimi dhe ndihmojnë në edukimin e amerikanëve mbi vendin dhe kulturën e tyre. Ky program mbështetet financiarisht nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

**Faza e parë e konkurrimit zhvillohet më 4 nëntor 2017, nga ora 8:30 deri në 11:00, tek Universiteti "Marin Barleti", Kampusi**

**2, rruga "Frang Bardhi", Selitë, Tiranë.**

Të gjithë nxënësit duhet të regjistrohen personalisht ditën e testimit. Testi i parë do të bëhet në të njëjtën ditë dhe orë që do të përcaktohet në momentin e regjistrimit. Për të gjithë ata që kualifikohen, testimi i dytë do të bëhet të nesërmen. Një listë me pjesëmarrësit e raundit të dytë do të bëhet publike në mbrëmjen e ditës së parë të testimit.

Nëse dëshironi të regjistroheni edhe

paraprakisht për testimin, dërgoni një e-mail në adresën [tirana@americancouncilssee.org](mailto:tirana@americancouncilssee.org)

Aplikanti duhet të plotësojë këto kushte:

- Datëlindja nga 1 janar 2001 – 15 korrik 2003
- Nxënës në shkollë të mesme, klasa 10 ose klasa 11
- Nxënës me rezultate të mira
- Të kenë nota të mira
- Njohuri të mira të gjuhës angleze
- Të jetë shtetas shqiptar
- Nxënës me aftësi të kufizuara duhet të jenë të lindur nga 15 shkurt 2000-15 korrik 2003

Dokumentet që duhet të paraqiten:

Aplikanti duhet të paraqesë:

- Fotografi të kohëve të fundit 3 x 4 cm;
- Pasaportë, certifikatë lindjeje ose kartë identiteti
- Një stilolaps të zi.

## Bashkia Kamëz, e ftuar në Forumin e Qeverisjes së Danubit "Përmirësimi i qeverisjes së bashku"



Bashkia Kamëz është ftuar të marrë pjesë në diskutimet si partnere në projektin e financiar përmes fondit BACID ("Ndërtimi i kapaciteteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Republika e Moldavisë"), "Krijimi dhe Institucionalizimi i Këshillit Rinor në Bashkinë Kamëz - Rinia Deliberative", i zbatuar në bashkëpunim me Qendrën për Integrim Evropian dhe Zhvillim (CEID).

Ftesa ka ardhur për pjesëmarrjen në Forumin e Qeverisjes së Danubit "Përmirësimi i qeverisjes së bashku", si ngjarje mbyllëse e fazës aktuale të programit BACID ("Ndërtimi i kapaciteteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Republika e Moldavisë").

Vepriaria do të zhvillohet më 4 dhjetor 2017 në Vjenë, në mjediset e përfaqësimit të Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian në Austri.

Në forum do të paraqiten praktikat më të mira të zhvilluara përmes programit BACID nga vende dhe sektorë të ndryshëm. Forumi do të mbledhë palët me të cilat ne kemi bashkëpunuar në vitet e fundit për të diskutuar përmirësimin e administratës publike dhe forcimin e qeverisjes vendor, duke promovuar bashkëpunimin e sektorit publik - institucionet kombëtare dhe lokale, shoqërinë civile, shkencën dhe sektorin e biznesit.

Përveç ministrive, qeverive lokale, OJQ-ve dhe organizatave të tjera nga rajoni, ngjarja do të mbledhë institucionet partnere publike dhe organizatat private nga i gjithë Rajoni i Danubit, si dhe përfaqësues të organizatave të BE-së dhe ndërkombëtare.

Ky forum është një mundësi për të zgjeruar bashkëpunimin në të ardhmen, si mjet kryesor që siguron qëndrueshmërinë e programit BACID dhe rrjetëzimin e vazhdueshëm.

Për këtë qëllim është ndërmarrë edhe nisma e Qendrës së Qeverisjes së Danubit.

## Bashkia Kamëz aplikon për çmimin "Kryeqyteti i Gjelbër i Evropës 2020"



Bashkia Kamëz po përgatitet të aplikojë për çmimin "Kryeqyteti i Gjelbër i Evropës 2020". Komisioni Evropian ka hapur thirrjen për "Kryeqytetin e Gjelbër" për vitin 2020.

Për herë të parë, për të festuar 10-vjetorin e këtij çmimi, fituesi i këtij titulli do të marrë edhe një stimul financiar prej 350,000 eurosh për të filluar programin e tyre mjedisor të vitit. Rreth 70% e qytetarëve të BE-së jetojnë në kryeqytete e qytete dhe numri i tyre pritet të rritet.

Titulli i "Kryeqytetit të Gjelbër të Evropës" i jepet çdo vit një qyteti të Evropës për angazhimin e tij mjedisor, social dhe qëndrueshmërinë ekonomike.

Të qenët "Kryeqyteti i Gjelbër i Evropës" sjell shumë përfitime: rrit turizmin, mbulim pozitiv ndërkombëtar i medias, rritje të profilit ndërkombëtar, lidhje dhe aleanca të reja, punë të reja – një Kryeqytet i Gjelbër i Evropës është më shumë atraktiv për investitorët e huaj, tërheqje e mbështetjes financiare publike, më shumë theks në projektet mjedisore nëpërmjet sponsorizimeve dhe granteve, nxit krenarinë lokale dhe gjeneron ndjenjë e përkatësisë, nxitje për të vazhduar në përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore, hyrja në rrjetin e fituesve të mëparshëm dhe në shortlistën e qyteteve të "Kryeqytetit të Gjelbër të Evropës" për të ndarë me ta idetë dhe eksperiencat.

Përveç kësaj, procesi i aplikimit në vetvete siguron përfitim në vlerësimin e progresit të qyteteve aplikuese dhe planeve të tyre. Konkursi për t'u bërë "Kryeqytet i Gjelbër i Evropës 2020" është tashmë i hapur nëpërmjet aplikimit online dhe Bashkia Kamëz për përgatit tërë dokumentacionin e nevojshëm për të qenë pjesë e këtij konkursi ndërkombëtar.

## Bashkia Kamëz, pjesë e projektit STAR 2 për sistemimin e arkivave sipas standardeve ligjore

Bashkia Kamëz do të jetë pjesë e projektit STAR 2, i cili ndër të tjera ka të bëjë me sistemimin e arkivave sipas standardeve ligjore. Projekti STAR 2 në ditët në vijim do të fillojë punën për asistencën e bashkive për sistemimin e arkivave sipas standardeve ligjore.

Ky proces është programuar si një përpjekje e përbashkët e bashkive me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, me drejtoritë rajonale të arkivave dhe me Agjencinë për Zbatimin e Reformës Territoriale.

Asistenca për sistemimin e arkivave vendore mbetet një nga drejtimet më të rëndësishme të punës gjatë zbatimit të projektit STAR 2.

Asistenca teknike, e cila do të zgjasë për një periudhë prej 14 muajsh, duke filluar nga muaji shtator 2017, parashikon:

- Vlerësimin e situatës aktuale të arkivave dhe stafit përgjegjës;
- Ofrimin e trajnimeve dhe certifikimit e njohurive të punonjësve;
- Monitorimin dhe ndihmën e specializuar në vendin e punës dhe online, si edhe certifikimin e procesit të arkivimit, bazuar në vlerësimin e performancës së punonjësve.

Përveç trajnimit dhe ndihmës në vendin e punës, projekti do të sigurojë edhe bazën materiale përfshirë kutitë dhe dosjet profesionale për arkivimin.

Në fund të projektit pritet që çdo bashki të ketë zbatuar standardet ligjore në procesin e arkivimit fizik për të mundësuar më tej dixhitalizimin, të ketë rritur ekspertizën teknike të stafit përkatës të bashkisë si dhe të ketë kryer procesin e arkivimit, të certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në mënyrë të pavarur.

Projekti aktual STAR 2 është zhvilluar në vazhdimësi të rezultateve të paraardhës të tij, projektit STAR, si dhe në përplotësim të asistencës së ofruar nga partnerë të ndryshëm për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative në nivel vendor. Partnerët ndërkombëtarë përfshijnë: Bashkimin Evropian, qeverinë e Suedisë përmes Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit, qeverinë e Italisë përmes Agjencisë Italiane të Zhvillimit, qeverinë e Zvicrës përmes Agjencisë Zvicerane të Zhvillimit dhe Bashkëpunimit, Shtetet e Bashkuara, përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe PNUD.





## Kryebashkiaku Xhelal Mziu inspekton punimet për asfaltimin përfundimtar të bulevardit "Demokracia" në Paskuqan

*Investimi në segmentin rrugor 7 km, shembull i punës dhe i investimeve të shumta të Bashkisë Kamëz.*

Investimi i Bashkisë Kamëz në rrugën "Demokracia" dhe në urën lidhëse me Tiranën ka një impakt të rëndësishëm social dhe ekonomik. Kryebashkiaku Xhelal Mziu, gjatë inspektimit të punimeve, ka theksuar se ky investim është ndër kategoritë e investimeve themelore që Bashkia Kamëz ka planifikuar për vitin 2017. Investimi, që është realizuar me fondet e Bashkisë, ka filluar me projektimin e rehabilitimit të plotë të këtij bulevardi, me të gjithë elementët e nevojshëm infrastrukturorë, nga gjendja tejet e rënduar që ka pasur ky terren. Impakti që jep ky investim është mjaft i rëndësishëm, sepse i shërben jo vetëm rreth 50.000 banorëve të Njësisë Administrative Paskuqan, por është një bulevard komunikues i lëvizjes së lirë të mjeteve edhe nga zona të tjera. Gjatësia e njërit prej segmenteve ku ka përfunduar asfaltimi është 130 ml, gjerësi 6 ml, bashkë me trotualet anash rrugës. Ndërkaq, ura lidhëse ka gjatësi 42 ml dhe gjerësi 4.2 ml.



### Rikualifikimi urban i bllokut Babrru-Qendër, inspekton punimet kryebashkiaku Mziu



Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka inspektuar ecurinë e punimeve për rikualifikimin urban të bllokut të pallateve në Babrru-Qendër, që po kthehet në një qendër qyteti me të gjitha standardet, falë punës dhe investimit të Bashkisë Kamëz. Ky projekt është ndër investimet e shumta të Bashkisë Kamëz në Njësinë Administrative të Paskuqanit. Në dallim nga qeveria, e cila për katër vjet radhazi ka diskriminuar Kamzën dhe Paskuqanin, duke mos akorduar asnjë fond për dhjetëra projekte emergjente, për të cilat qyteti ka nevojë, Bashkia, duke u mbështetur në të ardhurat e veta, po investon në infrastrukturën urbane të të gjitha lagjeve në Kamëz e Paskuqan. Rikualifikimi i bllokut të ndërtimeve në Babrru-Qendër është ndër investimet e shumta të Bashkisë Kamëz që po realizohet tërësisht me anë të buxhetit të kësaj njësie vendore, në një kohë kur nga qeveria shqiptare nuk është dhënë asnjë qindarkë për këtë qytet. Mbi 60% të buxhetit të Bashkisë ka shkuar për investime, duke qenë se qeveria e cila duhet të ishte e të gjithë shqiptarëve, nuk financon asnjë projekt jetik për banorët e Kamzës dhe Paskuqanit. Pjesën më të madhe të investimeve e ka përfunduar Njësia Administrative e Paskuqanit, ku po investohet në rrugë, kanalizime, në objekte arsimore e disa fusha të tjera, ku paraqiten nevoja emergjente dhe ka pasur kërkesa të shumta për ndërhyrje. Për sa i përket bllokut të ndërtimeve në Babrru-Qendër, rikualifikimi urban i tij është një projekt i cili rreth 1 miliard e 400 milion lekë ose më tepër sesa 1 milion euro dhe që do të ketë ndikim të gjerë social në komunitetin e banorëve të zonës.

### Në vëmendjen e Bashkisë, përmirësimi i infrastrukturës së arsimit në shkollat dhe kopshtet e qytetit



Kryetari i Bashkisë Kamëz, gjatë inspektimit të punimeve për rikonstruksionin e shkollës "Azem Hajdari" në Paskuqan, ka theksuar se në vëmendjen e Bashkisë Kamëz është edhe përmirësimi i infrastrukturës së arsimit në shkollat dhe kopshtet e qytetit, gjithashtu edhe krijimi i mundësive për ndërtimin e atyre të reja. Ai ka theksuar sërish se Bashkia Kamëz do të shfrytëzojë çdo mundësi e burim të saj për të ofruar një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor-edukativ, edhe në kushtet kur nga qeveria e majtë nuk ka ardhur asnjë qindarkë për investime në arsim për Kamzën. Ai garantoj se në mënyrë të pandërprerë do të paraqesë projekte konkurruese për ndërtimin e kopshteve dhe shkollave të reja, të cilat u shërbejnë të gjithë qytetarëve, familjeve dhe fëmijëve të qytetit të Kamzës. Kujtojmë se gjatë kohës së qeverisjes së Partisë Demokratike, në Kamëz u ndërtuan mbi 17 objekte shkollore, falë bashkëpunimit të Bashkisë me qeverinë, përveç rikonstruksionit të atyre ekzistuese. Ndërkaq, e kundërta ka ndodhur në katër vitet e qeverisjes së majtë, periudhë në të cilën nuk u dha asnjë qindarkë për projekte me karakter social, siç është ndërtimi i kopshteve apo i shkollave, por as për projekte në fusha të tjera jetike për qytetarët e Kamzës.

### Qeveria e majtë, e shurdhër ndaj kërkesave për financim të projekteve për ndërtimin e shkollave dhe kopshteve të tjera

"Arbëria", "100-vjetori", "Ahmet Zogu", "Demokracia", "Azem Hajdari", "Elez Isuf Ndreu", "Ibrahim Rugova", "Kamza e Re", "Dom Nikollë Kaçorri", Shkolla e re Profesionale – Këta janë vetëm disa nga emrat e shkollave dhe kopshteve të reja të ndërtuara në Kamëz që nga viti 2007, gjatë mandateve të kryebashkiakut Xhelal Mziu. Të gjithë qytetarët e dinë mirë se para vitit 2007 në Kamëz kishte vetëm tetë objekte shkollore, në një gjendje të mjerueshme. Falë investimeve të Bashkisë Kamëz, qeverisë së Partisë Demokratike dhe bashkëpunimit me partnerë të huaj u bë e mundur që të ndërtoheshin dhe të rikonstruktoshin dhjetëra kopshte dhe shkolla. Për gjashtë vjet, arsimit në qytetin e Kamzës ndërroi faqe, duke gëzuar një infrastrukturë bashkëkohore, me klasa, laboratorë dhe kabinete të veçanta për lëndët mësimore, me ambiente të larmishme për veprimtari sportive e kulturore. E kundërta ka ndodhur në katër vitet e fundit. Qeveria e majtë ka qenë e shurdhër ndaj kërkesave të Bashkisë për financim të projekteve për ndërtimin e shkollave dhe kopshteve të tjera, për të cilat ka ende shumë nevojë komuniteti i banorëve të Kamzës dhe Paskuqanit.


## Investimet e Bashkisë Kamëz në 10 vite, me karakter social, në ndihmë të mijëra qytetarëve

Investimet e Bashkisë në 10 vitet e fundit kanë qenë të pakrahueshme me periudhën e mëparshme. E rëndësishmja është se impakti i tyre të qytetarët dhe te vetë qyteti ka qenë dhe është i madh. Ka qenë ky qëllimi i kryebashkiakut Xhelal Mziu, i cili që në vitin e parë të mandatit të parë të tij ka synuar që dy të jenë drejtimet kryesore të Bashkisë Kamëz: investimet publike dhe shërbimet cilësore për qytetarët. Sot,

pas 10 vitesh, kushdo mund ta bëjë vetë diferencën, jo vetëm me të kaluarën, por edhe me njësitë e tjera vendore. Duke marrë në analizë investimet, vëren se kanë pasur edhe një ndikim të madh social. Kështu, janë me qindra kilometra rrugë të asfaltuara që u shërbejnë mbi 150 mijë banorëve, gjithashtu është një rrjet i tërë i ujësjellësit dhe i kanalizimeve, bërë i mundur falë investimeve të Bashkisë. Janë me dhjetëra

shkolla e kopshte të standardeve bashkëkohore, në të cilat marrin dijen nxënësit dhe fëmijët e Kamzës. Janë dhjetëra objekte sportive, kulturore, sociale, shëndetësore, fetare etj., që kanë bërë të mundur jo vetëm shërbimet përkatëse që ofrojnë, por kanë ndikuar edhe në jetën sociale të shtresave të popullsisë.





## Drejtoria e Tatimeve dhe Taksave Vendore, masa për të luftuar informalitetin

**350 biznese të reja kanë çelur aktivitetin e tyre si dhe kanë gjetur terrenin e duhur për ta ushtruar atë në Kamëz, falë taksave më të ulëta që përdoren në këtë njësi të qeverisjes vendore**

Drejtoria e Tatimeve dhe Taksave Vendore pranë bashkisë Kamëz ka përgatitur një plan operacional për të ulur informalitetin. Në zbatim të ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore", janë ngritur grupet e punës me specialistët e drejtorisë përkatëse për të konstatuar në terren të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet të ligjshëm tregtar brenda territorit të Bashkisë Kamëz. Qëllimi i këtij aksioni është monitorimi si dhe konstatimi i drejtpërdrejtë për çdo subjekt i aktivitetit si dhe raporti që këto subjekte kanë shlyerjet e detyrimeve ndaj institucionit Bashki.

Edhe pse ka një ecuri të mirë puna në këtë drejtori, akoma ka vend për të korrigjuar elemente të informalitetit. Kështu, specialistët e saj në kryerjen e funksioneve të tyre duhet të udhëhiqen nga ligji, për zbatimin e tij, dhe njëkohësisht mos dakordësimin me palët ndërvepruese për përmbushjen e detyrave të tyre.

Tashmë është e ditur që Bashkia Kamëz ka politikën më të mira



për të ushtruar një aktivitet tregtar, duke ndikuar në shumë element jetësorë, si në punësim ashtu edhe në zbutjen e konflikteve të elementëve socialë. Në këtë periudhë janë rreth 350 biznese të reja që kanë çelur aktivitetin e tyre si dhe kanë gjetur terrenin e duhur për ta ushtruar atë në Kamëz, falë taksave më të ulëta që përdoren në këtë njësi të qeverisjes vendore si dhe lehtësirave

të tjera të cilat krijojnë një klimë të favorshme biznesi. Puna e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ka konsistuar dhe vazhdon të konsistojë në realizimin e mbledhjes së të ardhurave dhe të debive të mbartura të subjekteve, në përmbushjen e detyrave dhe detyrimeve të paketës fiskale. Prandaj, terreni është një tjetër element për të bashkërenduar punët ndërmjet specialistëve të drejtorisë dhe subjekteve në bashkëpunimin për arritjen e një qëllimi përfundimtar.

Një buxhet i realizuar me sukses do të sjellë investime dhe shërbime cilësore për të gjithë qytetarët e Bashkisë Kamëz. Një tjetër element i rëndësishëm që po vepron në terren është edhe komunikimi me familjarë të cilët akoma nuk kanë shlyer detyrimet ndaj Bashkisë. Ky mjet komunikimi do të sjellë edhe një tjetër sukses, ku institucioni mbetet gjithmonë i hapur për të bashkëpunuar për detyrimet e ndërsjella.

Shtator 2017

GAZETA KAMZA



5

## Policia Bashkiake, e motivuar për të zbatuar me rigorozitet ligjin



Policia Bashkiake është një tjetër strukturë e Bashkisë Kamëz, që ka treguar se është e motivuar për të zbatuar me rigorozitet ligjin. Pjesë e punëve dhe detyrave funksionale të saj është edhe monitorimi i ambienteve dhe hapësirave publike të qytetit. Kështu, në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz janë monitoruar të gjitha ambientet ku tregtohet me pakicë dhe shumicë nga ana e tregtarëve. Ka vazhduar edhe këto ditë rritja e përgjegjësisë për zbatimin e rregullave për tregtimin e produkteve të pakicës dhe shumicës, por kryesisht të atyre që tregtojnë në ambiente të ndaluara, në trotuare apo ambiente, që ndoten në mënyrë të vazhdueshme.

Për të gjithë shkelësit e ligjit brenda një kohe mjaft të shkurtër janë vendosur masa disiplinore (gjoba), pas paralajmërimit të vazhdueshëm që u është bërë këtyre tregtarëve.

Bashkia Kamëz është e motivuar që nëpërmjet strukturave përgjegjëse të miradministrojë territorin për të krijuar të gjitha kushtet e nevojshme që tregtarët të realizojnë veprimtarinë e tyre brenda hapësirave të caktuara nga Bashkia.

Ndërkaq, është i gatshëm projekti për ndërtimin e një tregu multifunksional për të gjithë tregtarët, por për t'i krijuar mundësi punësimi dhe të interesuarve të tjerë për të krijuar vende të reja pune. Ndërkohë që projekti i Bashkisë është i gatshëm me të gjitha infrastrukturën e nevojshme, nga ana e qeverisë qendrore nuk ka asnjë pikë përgjegjësie për të mundësuar financimin e projektit për ndërtimin e këtij tregu.

Institucioni i Bashkisë, nëpërmjet strukturave të saj menaxhuese ka paralajmëruar të gjithë tregtarët, kudo qofshin ata, në qoftë se nuk do të zbatohet me rigorozitet ligjin, do të ketë masa ndëshkimore në vazhdim, pa tolerancë, për t'u dhënë mundësi të gjithë qytetarëve që të kenë hapësirat e duhura për të lëvizur lirisht në trotuare apo rrugë që shërbejnë për lëvizjen lirisht të tyre. Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka qenë i vendosur për të orientuar drejt punët në institucion, si për zbatimin e ligjit dhe për të qenë korrekt me të gjithë qytetarët në shërbimin ndaj tyre ashtu edhe për rritjen e performancës së institucionit

## Bashkëpunimi i Bashkisë me grupet e interesit rrit performancën e punës së Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Kamëz nuk e ka ulur aspak ritmin e saj në shërbimin e qytetarëve të Kamzës me ujë. Bashkëpunimi i frytshëm i Bashkisë Kamëz me qytetarët ka rritur cilësinë e shërbimit, pasi ata kanë treguar interes në këtë bashkëpunim të suksesshëm duke rritur ndërgjegjësimin, duke mirëmenaxhuar në mënyrë më të mirë përdorimin e ujit të pijshëm, duke përdorur ujin vetëm për nevojat e duhura. Mes qytetarëve të Kamzës, faturuesve dhe lexuesve të matësit të ujit ka pasur një koordinim dhe komunikim të shkëlqyer. Punonjësit e ndërmarrjes kanë qenë të përkushtuar maksimalisht çdo ditë për t'u ofruar qytetarëve shërbim cilësor, duke lexuar me korrektësi matësit, duke pasur komunikim të saktë me qytetarët, si dhe marrjen e informacioneve të nevojshme në terren nga çdo qytetar për ndonjë problematikë të tij. Në ato pak raste kur ka pasur ndonjë problem të vogël, punonjësit e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve kanë qenë menjëherë të gatshëm për t'u ardhur në nevojë qytetarëve në zgjidhjen e menjëhershme të problemit dhe në përmbushjen e shërbimit të tyre për qytetarin. Një tregues tjetër shumë i rëndësishëm që duhet të vlerësohet në këtë periudhë është përmirësimi i treguesve financiarë të mbledhjes së tarifës së ujit për të gjithë abonentët, duke disiplinuar në njëfarë mënyre edhe informalitetin, i cili në disa raste ka qenë i pranishëm në terren. Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka theksuar që të rritet performanca e çdo shërbimi të administratës së Bashkisë Kamëz për qytetarët e saj, ndaj të cilëve në çdo kohë duhet të ketë vëmendje të veçantë. Mbështetja e Bashkisë dhe bashkëpunimi me qytetarët do të vijojë të forcohet akoma më shumë.

## Përgjegjësi dhe përkushtim në shërbimet e sporteve të One Stop Shop-it në Bashkinë Kamëz



Një ngarkesë të jashtëzakonshme pune ka pasur ditët e shtatorit për të marrë shërbimet e nevojshme qytetarët në sportelet e One Stop Shop-it në Bashkinë Kamëz. Kjo ngarkesë ka kërkuar edhe një organizim të përsosur të punës nga ana e drejtorisë që mbulon shërbimet në këto sportele. Motivimi i punës është për t'u marrë shembull. Edhe pse ka një fluks të konsiderueshëm qytetarësh që u drejtohen këtyre sporteleve, po zbatohet një rregull i veçantë në respektimin e çdo qytetari për të marrë në kohë shërbimin e kërkuar. Është arritur që të fillojë puna më herët se orari zyrtar dhe të vazhdojë shërbimi derisa të largohet qytetari i fundit nga sportelet e shërbimit.

Projekti i parë që ka pasur Bashkia në vizionin e saj ka qenë ndërtimi i një One Stop Shop-i, i cili ka treguar se qysh nga momenti që është ndërtuar dhe deri më sot, ka funksionuar në mënyrë më të shkëlqyer, duke u shërbyer në vite qytetarëve të saj, duke larguar njëherë e përgjithmonë vuajtjet dhe radhët e gjata që kanë mbizotëruar në qeverisjet vendore para mandateve të z. Xhelal Mziu. Vizioni i kryebashkiakut ka dhënë impaktet e veta, gjë që tregon për seriozitetin që ka dhe do të ketë në të ardhmen për të pasur një infrastrukturë me komponentë shërbimi evropianë, duke qenë ndër njësitë e para të qeverisjes vendore që ka krijuar një investim të tillë.

Kryebashkiaku Mziu ka kërkuar edhe nga kjo strukturë që shërben pranë sporteleve të One Stop Shop-it një përgjegjëshmëri maksimale dhe përkujdesje në komunikimin me qytetarët për të marrë shërbimin e tyre cilësisht nga ky staf. Zyrat e Gjendjes Civile vazhdojnë të punojnë gjithashtu me orare të zgjatura në përmbushje me sukses të detyrave dhe shërbimeve, duke pasur një ngarkesë maksimale dhe duke treguar një performancë mjaft të mirë.





# Talenti i Kamza Basket, Ergys Muhametaj, krahi lojtarëve të moshave të ekipeve si Real Madrid, Barcelona, Fenerbahçe e kolegjeve amerikane

**Supertalenti Muhametaj: Xhelal Mziu, dashmirësia e tij për sportin e basketbollit dhe krijimi i mundësive për t'u marrë me këtë sport kaq të bukur kanë qenë mbështetëse për arritjet e mia**

Intervistoi: Edmond Duraku

16-vjeçari i Kamza Basket, Ergys Muhametaj, i cilësuar talenti më i madh i basketbollit shqiptar, në rankingun botëror të bërë nga FIBA për datëlindjet 2001, është renditur i 28-ti në 100 vendet e para, pra i 28-ti më i miri në botë për moshën e vet. Emri i Ergysit qëndron krahi lojtarëve të moshave të ekipeve si me emër në botë në basketboll si Real Madrid, Barcelona, Fenerbahçe e kolegjeve amerikane. Pa dyshim që kjo është arritja më e madhe që ka pasur ndonjëherë një basketbollist shqiptar në historinë e basketbollit të vendit tonë. Ka marrë pjesë në 2 Kampionate Evropiane me kombëtaren U16 të Shqipërisë, gjithashtu ka pasur kërkesa edhe me kombëtarët e Shqipërisë të grupmoshave të tjera si U18 etj. Në Kampionatin Evropian të moshës U16, vjet në Qipro, kur ishte vetëm 15 vjeç, doli më i miri i kombëtares shqiptare U16 sipas statistikave. Edhe sivjet në Andorra, Spanjë, doli sipas statistikave më i miri në pozicionin e vet në gjithë Kampionatin Evropian U16. Kërkesat për talentin e Kamza Basket, Ergys Muhametaj, kanë qenë



më pas dhe Erkand Karajit, Agollit, Shimës, e shumë e shumë lojtarë të tjerë që këto dy dekadat e fundit i kanë dhënë tonin e basketbollit shqiptar. "Duhet theksuar se një ndër kushtet mbështetëse për arritjet e mia, - shprehet Ergysi, - ka qenë edhe dashmirësia e kryetarit të Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, për sportin e basketbollit dhe krijimi i mundësive për t'u marrë me këtë sport kaq të bukur si unë dhe shumë të tjerë djem dhe vajza të këtij qyteti". Ndërsa sa i përket Kampionatit Kombëtar 2017-2018, supertalenti Muhametaj thotë që sivjet Kamza ka një ekip shumë të ri, me moshë mesatare afër 20 vjeç, me disa djem nga qyteti ynë, Kamza, të cilët premtajn shumë për të ardhmen. Premton që të japë kontributin maksimal që Kamza të ngelet gjithmonë në elitën e basketbollit shqiptar. Në prag të fillimit të kampionatit kombëtar të basketbollit, intervistë me njërin prej talenteve më të mëdha të basketbollit shqiptar, pjesë e ekipit të rritur të Kamzës, Ergys Muhametaj.

**Dëshira për t'u bërë basketbollist lindi prej babait tuaj, që është një trajner i mirënjohur, apo prej pasionit që keni për basketbollin, edhe pse është sport jo shumë i zhvilluar në Shqipëri?**

Pa dyshim që të dyja së bashku kanë ndikuar. Fatmirësisht babai im ka luajtur basketboll e tani është trajner, vëllai im aktualisht luan basketboll dhe është po ashtu dhe trajner i moshave njëkohësisht. Unë që i vogël jam rritur në gjirin e një ekipi si Kamza Basket, kampion dhe fitues i të gjitha trofeve për vite me radhë në këtë sport që është sporti i dytë në Shqipëri. Kam pasur rastin e madh të jem afër lojtarëve më të mëdhenj shqiptarë të kohëve të fundit.

**Cilët ishin hapat tuaj të parë në karrierën tuaj në basketboll?**

Për herë të parë kam luajtur me moshat U-12 të ekipit Kamza Basket, me të cilin atë vit



dolëm në 4 ekipet më të mira shqiptare. Më pas kam luajtur me të gjitha ekipet zinxhir të këtij ekipi dhe kam 3 vite që jam pjesë e ekipeve kombëtare në aktivitetet që FIBA organizon.

**Ju jeni i vetmi basketbollist në Shqipëri që luani me tre grupmoshat e Kamzës, paratërinjtë, me të rinjtë, dhe me ekipin e të rriturve.**

Unë vërtet jam në moshe të re, por ama i jam përkushtuar shumë këtij sporti dhe shpeshherë kam pasur edhe fat. Jam pjesë e të gjitha këtyre ekipeve, por për momentin për mua është më shumë se gjithçka përgjegjësi për të punuar më shumë.

**Sa ju ka ndihmuar babai juaj në rritjen tuaj si basketbollist? Po lojtarët e Kamzës me përvojë kanë ndikuar në ambientimin tuaj me ekipin e parë?**

Unë e thashë dhe pak më lart që fati më ka ndihmuar, por sigurisht ndihma nga babai dhe vëllai im më i madh kanë qenë permanente dhe shumë e madhe, por të them të drejtën kam qenë shumë i ri kur e kam parë veten afër Afrim Bilalit, më pas dhe Erkand Karajit, Agollit, Shimës e shumë e shumë lojtarë të tjerë që këto dy dekadat e fundit i kanë dhënë tonin e basketbollit shqiptar.

**Lidhur me mbështetjen e vazhdueshme të kryebashkiakut Xhelal Mziu për sportin e basketbollit, cili është mendimi juaj?**

Duhet theksuar se një ndër kushtet mbështetëse për arritjet e mia ka qenë edhe dashmirësia e kryetarit të Bashkisë, z. Mziu, për sportin e basketbollit dhe krijimi i mundësive për t'u marrë me këtë sport kaq të bukur si unë dhe shumë të tjerë djem dhe vajza të këtij qyteti. **Absolutisht jeni ndër talentet e rinj më të mëdhenj të basketbollit në Shqipëri. Cilat janë synimet tuaja për të ardhmen?**

Për momentin unë po stërvitem dhe po luaj një sport i cili më pëlqen jashtëzakonisht shumë dhe fatmirësisht jam në një grup mjaft të mirë dhe të gjithë bashkë ndihemi shumë komodë për të vazhduar punën më me këmbëngulje, sepse kushtet që na ofrohen janë shumë të favorshme. Unë kam shumë

për të falënderuar, por në veçanti do të falënderoj zotin kryetar, i cili ka mbështetur sportin e basketbollit, që do të thotë se do të punoj duke rritur vazhdimisht tempin për të arritur rezultate sa më të larta.

**Po në rang kombëtar, ke përfaqësuar U-16 e Shqipërisë në shumë aktivitete. Cilat kanë qenë rezultatet tuaj me kombëtaren e moshave?**

Vjet në Qipro, kur isha vetëm 15 vjeç dola më i miri i kombëtares sonë U-16 sipas statistikave. Dhe sivjet në Andorra, dola sipas statistikave më i miri në pozicionin tim në gjithë kampionatin evropian U-16.

U	PG	BC	Mess (LUX)	N/A
19	Sacha Piras (164-PG)	High School (FRA)		N/A
20	Jamie Meale (169-F)	GIB U16 NT (GIB)		N/A
21	Albert Pons (187-G)	AND U16 NT (ESP)		N/A
22	Marck Vyrosbal (192-PG)	USK Praha (CZE)		N/A
23	Lukas Herzog (187-PG)	Ludwigsb.BSG (GER)		N/A
24	Mohammed Abbas (178-PG)	High School (IRQ)		N/A
25	Papuna Kirtetse (180-PG)	High School (AZE)		N/A
26	Tommaso Felici (196-F/C)	High School (ITA)		N/A
27	Ergys Muhametaj (197-G/F)	Kamza Basket (ALB)		N/A
28	Franz Wagner (195-G)	ALBA (GER)		N/A
29	Viktor Christofidis (181-G)	Zinonas (CYP)		N/A
30	Maximilian Beque (193-G)	Fraport SKY (GER)		N/A
31	Daniel Zdravovskii (204-F)	Hagen BG 2 (GER)		N/A
32	Sam Wolter (166-PG)	Etzella (LUX)		N/A
33	Matej Rudan (198-C)	Cibona (CRO)		N/A
34	Amar Svila (205-C)	Real Madrid (ESP)		N/A

**Cilat janë avantazhet ndaj bashkëmoshtarëve tuaj?**

Shumë pak, për të mos thënë asnjë nga moshataret e mi nuk e ka pasur mundësinë dhe privilegjin të luajë me lojtarë kaq cilësorë, në një ekip me emër dhe me kushte të tilla, sigurisht edhe me dëshirën për sport.

**Pyetja e fundit, çfarë synoni prej sezonit 2017-2018?**

Në sivjet kemi një ekip shumë të ri me moshë mesatare afër 20 vjeç, kemi edhe disa djem nga zona jonë, Kamza, të cilët premtajn. Do të mundohem që të jap kontributin tim maksimal, që Kamza të ngelet gjithmonë në elitën e basketbollit shqiptar.



të mëdha e vazhdojnë të jenë nga vjet nga ekipe të mëdha në Evropë, siç janë ekipe në Greqi, Turqi, Itali, Lituani, Kroaci, Kosovë dhe nga shumë ekipe të Kampionatit tonë Kombëtar si Tirana, Teuta etj. Karriera e tij basketbolliste filloi me ekipin U12 të ekipit Kamza Basket, më pas ka luajtur me të gjitha ekipet zinxhir të këtij ekipi dhe që prej 3 vitesh është pjesë e ekipeve kombëtare në aktivitetet që FIBA organizon. Ndikim të madh në maturimin e tij të shpejt si basketbollist kanë ndikuar babai i tij, trajneri i mirënjohur Adem Muhametaj si dhe vëllai i tij, Gledis Muhametaj, i cili edhe ai është trajner i ekipeve të moshave të Kamzës. Është i vetmi basketbollist në Shqipëri që luan me tre grupmoshat e Kamzës, paratërinjtë, me të rinjtë dhe me ekipin e të rriturve, i cili e quan përgjegjësi të madhe për të punuar më shumë. Ndikim të madh në rritjen e tij të shpejtë në basketboll kanë ndikuar edhe basketbollistë që kanë bërë emër në basketbollin shqiptar, ish-lojtarë të ekipit kombëtar, Afrim Bilalit





# Mbrojtësi i djathtë i Kamzës, Frashëri: Në ndeshjet e para kemi qenë të pafat

Shtator 2017  
GAZETA KAMZA

7

**Shumë e rëndësishme dhe motivuese për skuadrën mbështetja e kryebashkiakut Xhelal Mziu dhe presidentit Qarri, të cilët kanë ndërtuar një ekip konkurrues për në Superligë**

**Intervistoi: Edmond Duraku**

Skuadra e Kamzës u kualifikua me meritë për në turin e dytë të Kupës së Republikës, duke mundur ekipin e Ilirisë në ndeshjen e dytë me rezultatin 5-1, ndërsa kalon në turin tjetër me rezultat të përgjithshëm 7-1. Takimi i parë kishte përfunduar me rezultatin 2-0 në favor të kamzalinjve.

Në fushën e blertë zbriti sikapiten i ekipit të Kamzës mbrojtësi i krahut të djathtë, Erlis Frashëri, një nga më të mirët në fushë për skuadrën e Kamzës, duke realizuar edhe një gol të bukur me kokë.

Në përfundim të ndeshjes, Frashëri tha që ekipi e meritoi kualifikimin dhe që lojtarët e aktivizuar dhanë maksimumin e tyre, duke merituar besimin e trajnerit, ndërsa tani synojnë edhe kalimin e turit tjetër ku do të ndeshen me Teutën. Sa



u përket tri ndeshjeve të para të kampionatit, mbrojtësi i cili është pjesë e skuadrës së Kamzës prej dy vitesh, theksoi se ekipi nuk e meriton renditjen që është momentalisht, pasi në të tria takimet kanë zhvilluar ndeshje të bukura, por fati nuk ka qenë në favorin e tyre. Edhe pse pothuajse ekipi është i ndryshuar nga i vjetshmi, Frashëri pohon që pavarësisht që ekipi është i ri, kanë punuar fort në fazën përgatitore dhe beson që ekipi do të marrë shumë shpejt më të mirën e tyre. Erlis Frashëri e konsideron shumë të rëndësishme dhe motivuese



për skuadrën mbështetjen e kryebashkiakut Xhelal Mziu dhe presidentit Qarri, të cilët kanë ndërtuar një ekip konkurrues për në Superligë. Thekson faktin që Mziu i ndjek në të gjitha ndeshjet që zhvillon skuadra e Kamzës si brenda ashtu edhe jashtë, po ashtu edhe gjatë stërvitjeve. Në aspektin profesional synon që të bindë trajnerin, duke dhënë maksimumin e mundshëm, si në stërvitje ashtu edhe në lojë që ta meritojë formacionin titullar.

Intervistë ekskluzive për gazetën "Kamza" e mbrojtësit të krahut të djathtë, Erlis Frashëri.

**Si u paraqit ekipi i Kamzës në ndeshjen e Kupës ndaj Ilirisë dhe cili është komenti juaj pas këtij kualifikimi?**

Mendoj se pavarësisht që nuk kishim 11-shen titullarë, skuadra luajti zhvilloi një lojë shumë të bukur, duke e dominuar në çdo aspekt. Fitoren e merituar, pasi çunat të gjithë që u aktivizuan, luajtën në maksimumin e tyre. Tani shpresojmë shumë ta kalojmë edhe turin tjetër ndaj Teutës.

Javën e parë e nisët ndeshjen nga stoli, ndërsa në këto dy javë keni qenë në formacionin titullar. Cilat janë synimet tuaja për ndeshjet e ardhshme?

Po, është e vërtetë, e nisa nga stoli. Kështu e mendoj trajneri me Skënderbeun edhe me Lushnjën kam qenë titullar. Synimi është të marrim 3-pikësh, sepse i kemi kualitetet. Kemi ekip shumë të mirë, këtë gjë e kemi treguar në Kukës, pavarësisht se ne humbëm, treguam edhe me Skënderbeun që kemi ekip.

**Dy javët e para jeni ndeshur me dy ekipe shumë të forta, ndërsa ndaj Lushnjës, ndaj një rivali direkt, jeni të kënaqur me pikën e marrë në transfertë apo jeni të mërzitur, pasi synoni 3-pikëshin?**

Me Lushnjën duhet te fitonim, por futbollit prandaj është i bukur, ka edhe 3 rezultate.

**Tashmë si paraqitet atmosfera në ekipin e Kamzës pas dy barazimeve radhazi?**

Ne po punojmë fort për ndeshjen me Teutën. Atmosfera është shumë e mirë u mërzitem pak për barazimin me Lushnjën, po tani ajo është një faqe e mbyllur.

**Jeni konsoliduar si ekip apo keni nevojë akoma të njiheni në fushën e blertë, duke qenë se pothuajse i gjithë ekipi është ndryshuar nga ai i kaluarit pas ngjites në Superligë?**

Jemi një ekip i ri, kemi punuar fort në fazën përgatitore edhe besoj që ne i marrim njëri-tjetrit më të mirën.

**Çfarë impakti ka tek ju mbështetja e kryebashkiakut Xhelal Mziu për ekipin e Kamzës në futboll?**

Mbështetja e kryetarit është shumë motivuese për ekipin. Më pëlqen fakti kur ai vjen na sheh në stërvitje. Unë personalisht kam dy vjet që jam pjesë e Kamzës. Nga kryetari deri tani nuk ka munguar asgjë, duke na mbështetur në çdo ndeshje. Më bëri përshtypje para ndeshjes me Korçën, unë kam luajtur në shumë ekipe, por kurrë nuk kisha parë kryetar bashkie të ndodhej në analizën e ekipit. Merita i takon atij së bashku me presidentin Naim Qarri që ekipi i Kamzës është sot në Superligë.

## Ansambli i Kamzës vlerësohet me çmimin "Margaritar i Kulturës Popullore" në festivalin e folklorit "Burimet e Sharrit"



Ansambli i Kamzës, pas një performace të shkëlqyer, u vlerësua me çmimin "Margaritar i Kulturës Popullore", në festivalin e folklorit të përpunuar "Burimet e Sharrit". Ky ishte edicioni i 16-të që zhvillohej në Tetovë të Maqedonisë, ndërsa për ansamblin e Kamzës ishte hera e dytë që merrte pjesë në këtë festival të folklorit të përpunuar. Artistët e Kamzës shfaqën nivelin mjaft të kënaqshëm, duke merituar plotësisht çmimin. Me të dalë në skenë valltarët e Kamzës, gjatë performancës dhe në përfundim të saj morën duartrokitjet e artdashësve të shumtë të pranishëm, pasi

për artistët duartrokitjet janë vlerësimi më i mirë për ta. Kamza në këtë festival me karakter garues u prezantua me Vallen e Rrajcës, të Dibrës, si dhe me këngë nga të gjitha trevat shqiptare. Pjesë të ansamblit të Pallatit të Kulturës së Kamzës në këtë event ishin valltarët e talentuar të ansamblit "Kaltërsia" si dhe solistët e mirënjohur, të cilët janë gjithmonë pjesë e veprimtarive të pallatit të kulturës. Vlerësohet mbështetja e kryetarit të Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, për mundësinë që i krijoi ansamblit të Kamzës për të qenë pjesë në këtë festival të rëndësishëm.

Në fillim të festivalit shoqëritë kulturore artistike erdhën me veshjet tradicionale, të cilat i bënin krenarë edhe valltarët të cilët ecnin lirshëm në skenë. Gjatë performancës, secila shoqëri kishte larmi veshjesh karakteristike të secilës krahinë. E veçantë e këtij festivali ishte se një nga shoqëritë kulturore shfaqti një xhamadan të gjetur 100 vite më përpara.

## Takimi i interpretuesve "Fjala gdhend gurin", zhvilluar në Pallatin e Kulturës Kamëz



Është zhvilluar me sukses në skenën e Pallatit të Kulturës Kamëz takimi i interpretuesve "Fjala gdhend gurin". Ky ishte një tjetër bashkëpunim i teatrit amator "Rikthim" me Pallatin e Kulturës Kamëz, me idenë e poetit Bajram Torba dhe moderimin e Eltona Lakuriqit, zhvilluar nën kujdesin e kryebashkiakut Xhelal Mziu. Juria e përbërë nga Lola Shehi, Fejzi Murati

dhe Franc Begu vlerësuan interpretuesit më të mirë:

Çmimi i parë - Gerta Cano  
Çmimi i dytë - Emerlinda Sheti  
Çmimi i tretë - Lediona Braho.  
Ndërkaq, pati edhe çmime të tjera: Interpretuesja më e re - Sibora Huta  
Çmimi i publikut - Adela Hilaj  
Çmimi special - Dritan Thomarai.





## Takimi me përfaqësuesin e kompanisë “Dahlem”, kryebashkiaku Mziu: Jam i vendosur për të mbrojtur qytetarët e Kamzës

Në mjediset e Bashkisë, kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në një takim z. Uwe Moshage, përfaqësuesi i kompanisë “Dahlem”, e cila zbaton projektin e ujësjellësit në qytetin e Kamzës, mundësuar nga KfW. Pas fjalës mikpritëse të kryebashkiakut Mziu, z. Moshage vlerësoi maksimalisht punën e Bashkisë në drejtim të performancës së shkëlqyer të deritanishme të menaxhimit të sistemit të rehabilituar të ujësjellësit. Ai nënvizoi se ka një fizibilitet të dukshëm në këtë drejtim dhe për këtë KfW ka gati investimin për fazën e dytë të projektit. Duke parë këtë ecure të dukshme, Bashkia Kamëz është kualifikuar për të përfituar fazën e dytë të zbatimit të investimit. “Fillimviti është periudha kur do të kemi gati këtë investim”, - theksoi përfaqësuesi i kompanisë “Dahlem”. Nga ana tjetër, paraqitja e suksesshme e deritanishme e Ndërmarrjes së Ujësllës-Kanalizimeve në arritjen e treguesve të marrëveshjes ka bërë të mundur që do të investohet edhe në KUN. Ndër të tjera, z. Moshage përmendi edhe disa zona të Bathores të planifikuara për fazën e parë, por



që nuk e kanë përfituar investimin dhe që janë përfshirë në fazën e dytë të projektit.

Ndërkaq, kryebashkiaku Xhelal Mziu, pasi bëri një analizë të thellë të zbatimit të projektit në fazën e parë, falënderoi institucionin që bëri

të mundur këtë projekt në qytetin e Kamzës, vuri theksin te serioziteti që kërkohet për të zbatuar pikë për pikë marrëveshjen me KfW, “Dahlem” dhe aktorë të tjerë të përfshirë në të. Z. Mziu tha se përfitimi i investimit është në interes dhe në vëmendje ndaj shërbimeve të qytetarëve të Kamzës, me një kosto sa më të ulët, referuar marrëveshjes. Bashkia Kamëz furnizohet me ujë nga dy burime kryesore: nga nënstacioni i pompave në Valias dhe nga rezervuari me rrjedhje të lirë i Bovillës. Duke qenë që Bashkia gëzon 14.4% të aksioneve në rezervuarin e Bovillës, gjë që do të thotë se ka të drejtën e furnizimit me ujë nga ky rezervuar, këtë përqindje të ujit të përdorshëm për furnizim ajo e merr një sasi jo të respektuar sipas kontratës me ndërmarrjen e Ujësllës Tiranë, juridiksion i Bashkisë Tiranë, duke e blerë me një kosto 4 herë më të lartë se përpara disa kohësh. Kjo bën që zbatimi i fazës së dytë kërkon investimin e një tubacioni me një gjatësi rreth 1 km për të zbutur në mënyrë të ndjeshme humbjet, që janë rreth 65%, në rrjetin e furnizimit nga rezervuari i Bovillës dhe për të marrë sasinë e nevojshme me një çmim shumë më të ulët sesa sot dhe për të

rritur sasinë e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Kamzës. “Jam i vendosur për të mbrojtur qytetarët e Kamzës për të drejtën themelore të respektimit të marrëveshjes për furnizimin me ujë me rrjedhje të lirë nga rezervuari i Bovillës, i cili do të bëjë të mundur zbatimin me rigorozitet të fazës së dytë të projektit të KfW-së”, - shpreh z. Mziu. Një çështje tjetër e rëndësishme që preku në këtë takim kryebashkiaku Mziu, ishte edhe vëmendja dhe shpejtimi i hapave që në këtë fazë të investohet edhe në KUN. Bashkia ka caktuar një buxhet prej 60% për investime nga të cilat pjesa më e madhe e tyre shkon për KUN. “Janë me dhjetëra madje me qindra kanale dhe kolektorë të hapur në të gjithë territorin e Bashkisë që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, por Bashkia nuk e ka kapacitetin e duhur financiar. Prandaj, kërkohet bashkëpunim dhe bashkërendim ndërmjet Bashkisë dhe KfW-së për të përshpejtuar investimet edhe në këtë drejtim”, - theksoi z. Mziu, i cili e mbylli fjalën e tij duke kërkuar një bashkërendim më konkret për të respektuar marrëveshjet në interes të qytetarëve të Kamzës.

### Kryebashkiaku Xhelal Mziu dhe drejtori i Përgjithshëm i kompanisë SIGAL, Avni Ponari, në klinikën lëvizëse në Bathore



Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu dhe drejtori i Përgjithshëm i kompanisë SIGAL, z. Avni Ponari, ishin në klinikën lëvizëse në Bathore. Kjo klinikë ishte një bashkëpunim i Bashkisë Kamëz me kompaninë SIGAL (UNICA GROUP AUSTRIA), e cila ofroi shërbime për kontroll shëndetësor falas për periudhën 13.9.2017-17.9.2017. Pajisjet e kësaj klinike janë marrë nga Austria dhe me to u shërbye falas gjatë periudhës së mësipërme për të gjithë qytetarët e Kamzës për rreth 15 specialitete, duke krijuar një standard të lartë shërbimi. Falë bashkëpunimit të Bashkisë Kamëz dhe kompanisë SIGAL u bë i mundur për qytetarët kontrolli shëndetësor falas me mjekët më të mirë të shërbimit shëndetësor, për të sjellë kështu një shërbim të dobishëm për ta. Kjo iniciativë e partneritetit publik-privat ishte një mundësi e shkëlqyer e përgjegjësive për shërbimet ndaj qytetarëve të Kamzës, falë seriozitetit dhe vizionit të kryebashkiakut Xhelal Mziu, i cili ka qenë gjithnjë i gatshëm për të bashkëpunuar ngushtësisht me institucione prestigjioze, shtetërore ose privatë, siç është në rastin konkret bashkëpunimi me kompaninë më të shërbimit në fushën e sigurimeve, SIGAL.

### Greqi, Kesler Mziu përfaqëson Shqipërinë denjësisht në Finalen e Kangaroo Global Linguistic, fiton vendin e parë për moshën e tij



Kesler Mziu, nxënës i shkollës “Turgut Ozal”, në klasën e 5-të, kryesoi listën e nxënësve të përzgjedhur për konkursin e Kangaroo, finalja e të cilit u zhvillua në Greqi. Ky konkurs ndërkombëtar zhvillohet një herë në vit dhe është i hapur për të gjithë nxënësit nga klasa e 3-të deri në klasën e 12-të, pra nga moshë 8-18 vjeç. Kjo ishte hera e parë që në Shqipëri u organizua olimpiada e gjuhës Angleze Kangaroo Global Linguistic (KGL). Lajmin e mirë të fitores së Olimpiadës Kombëtare të Gjuhës Angleze në Shqipëri e ka ndarë në rrjetet sociale i ati, kryebashkiaku Xhelal Mziu, i cili nuk kursen vlerësimet për të birin duke pohuar se është një frymëzim për atë. “Gjithmonë jam përpjekur të jem shembull i mirë dhe frymëzim për qytetin tim Kamëz! Por, frymëzim për mua u bë im bir!”, - shkruante Mziu në FB. Pas fitores në Greqi, Klubi i Medias pranë “Turgut Ozal” i mori një intervistë nxënësit fitues të Kangaroo Global Linguistic (KGL) për grupmoshën 10-vjeçare, Kesler Mziu, për ta pyetur për emocionet dhe mbresat e tij nga konkursi që zhvilloi vetëm para pak ditësh në Greqi. Pyetje: “Ky ishte hapi i parë i parë i konkursit. Po më pas si vazhdoi?

Jemi kureshtarë të dimë për eksperiencën tënde në konkursin ndërkombëtar, mbresat nga ky konkurs dhe përjetimet e tua në momentin e shpalljes fitues i vendit të parë”, Kesler Mziu i përgjigjet: “Siç e thatë edhe ju, konkursi në Tiranë ishte hapi i parë, i cili më krijoi mundësinë të isha pjesëmarrës në Greqi. Aty konkurrimi ishte më i fortë, pasi merrnin pjesë fëmijë nga vende të ndryshme, si: Shqipëria,

Rumania, Bullgaria, Greqia, deri edhe nga Japonia. Organizimi i konkursit në Greqi ishte shumë ndryshe nga ai i Tiranës. Ditën e parë bëmë njohjen me bashkëmohatarrët nga vendet e tjera që merrnin pjesë në konkurs. Ajo ishte dita ku të gjithë zumë shokë e shoqe të rinj, pasi kishte shumë fëmijë e të rinj nga disa shtete dhe të tërë ishin tepër miqësorë. Dita e dytë ishte e mbushur me emocionet e konkursit. Ky konkurs u zhvillua përsëri në tri faza: Në fillim na morën në një intervistë dhe kjo ishte faza e provimit me gojë. Më pas, zhvilluam ushtrime në kompjuter dhe kjo ishte faza e dytë, ajo e gramatikës. Ndërsa faza e tretë ishte ajo e shkrimit të një letre në gjuhën angleze drejtuar një bashkëmohatari kudo në botë. Këtu vlerësohej jo vetëm sa saktë shkruan në gjuhën angleze, por edhe sa e bukur dhe me kuptim ishte e gjithë letra që kishe shkruar. Mbasdite u ndanë çmimet dhe unë zura përsëri vendin e parë. Lumturia ime dhe e njerëzve të mi ishte shumë e madhe. Kur u thirr emri im u ndjeva krenar për familjen time, shkollën ku mësoj, por mbi të gjitha isha krenar për vendin tim”.